

A K T - T H E M E L I M I

I SHOQËRISË ME PËRGPJEGJËSI TË KUFIZUAR " ÇEKANI " SH.P.K.

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar " ÇEKANI " shpk, e përfaqë  
suar nga administratori themelues Z. Hajdar Çekani, është person juridik  
dik me qendër në qytetin e Librazhdit.

ARTI 1

Administratori i vetëm me cilësimin e themeluesit Z. Hajdar Çekani,  
i biri i Hamitit dhe Kadifes, lindur më 17 Dhjetor 1959, me banim  
në qytetin e Librazhdit, vendosi të themelojë Shoqërinë " ÇEKANI " shpk  
me përgjegjësi të kufizuar, me seli në qytetin e Librazhdit.

ARTI 2

Shoqëria Private " ÇEKANI " shpk, është person juridik dhe  
veprimtarinë e saj e rregullon në bazë të legjislationit shqiptar në  
fuci, Aktit të Themelimit dhe Statutit.

ARTI 3

Shoqëria Private " ÇEKANI " shpk, do të ushtrojë aktivitetet për  
një periudhë të pacaktuar kohe.

ARTI 4

Objekti i Shoqërisë Private " ÇEKANI " shpk është:

1. Prodhimi, tregëtimi, shfrytësimi i pyjeve, përpunimi i lëndës  
drusore dhe i qumësve prej druri, i gëllqerës për eksportin e saj etj
2. Mbarështrimi i pyjeve.
3. Përmirësimi i pyjeve.
4. Pyllëzime.
5. Sisteminë malorë.
6. Mbarështrimi i florës barishtore, mjekësore, tanifere.
7. Mbarështrimi i faunës myjore.
8. Mbrotja nga sëmundjet, dëmtuesit nga azerri.
9. Mbarështrimi i kullotave dhe livadhave.
10. Ndërtimi, meremetimi i veprave ujore në kullota e livadhe.
11. Tregëtimi me shumicë i mallrave të ndryshme ushqimore, in

Hajdar Çekani  
Çekani

triale, të ndërtimit etj.

ARTI 5

Kapitali Themelor i Shoqërisë Private " ÇEKANI " shpk është 100.000 ( Njëqinda mijë ) lekë.

ARTI 6

Rregullat e Shoqërisë Private " ÇEKANI " shpk janë përcaktuar në Statutin bashkëngjitur kësaj akti.

ARTI 7

Drejtimi i Shoqërisë Private " ÇEKANI " shpk do të bëhet nga Z. Hajdar Çekani, si themelues i vetëm i shoqërisë.

THYENI YËNË I SHOQËRISË

HAJDAR ÇEKANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

NOTERIA TIRANË

Nr. 5035 Rep.

Nr. 133/Kol.

V E R T E T I M

Sot më datë 11 / 6 / 1997, në Zyrën e Notarisë Tiranë para meje noteres Alumona Paolise, u paraqit personafisht qytetari Hajdar Çekani, i biri i Hamitit, i datlindjes 1959, banues në qytetin e Librazhdit, me Nr. Letërnjoftimi UG Nr. 090492, madhor, me notësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit i sigurova nga Letërnjoftimi i paraqitur, i cili deklaron se ka hartuar vetë Aktin e Themelimit dhe pasi është nënshkruar prej tij, vërtëtohet nga una Noteria.



# STATUTI

## I SHOQËRISË " ÇEKANI " SH.P.K. LIBRAZH

### ARTIKulli 1

Shoqëria " ÇEKANI " SHPK Librazhd krijohet nga themeluesi i vetëm Hajdar Çekani në bazë të dispozitave të përcaktuara në ligjin 7512, datë 10.03.1991, të Ligjit Nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregëtare".

### ARTIKulli 2

Shoqëria private " ÇEKANI " Shpk ushtron veprimtarinë e saj në bazë të ligjeve të ekonomisë së tregut.

### ARTIKulli 3

Shoqëria private " ÇEKANI " Shpk është person juridik dhe fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin e saj në Gjykatën e Rrethit Tiranë dhe palet me liron e ushtrimit të profesionit në Zyrën e Tatim-Taksave në rrethin Librazhd.

## ARTIKulli 4. SELIA, TERRITORI

### ARTIKulli 4

Emërtimi i shoqërisë private do të jetë " ÇEKANI " SHPK Librazhd

### ARTIKulli 5

Selia e Shoqërisë private " ÇEKANI " Shpk Librazhd do të jetë në qytetin e Librazhdit.

### ARTIKulli 6

Shoqëria Private " ÇEKANI " Shpk do të zhvillojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

### ARTIKulli 7

Aktiviteti i shoqërisë private " ÇEKANI " Shpk do të zhvillohet në një kohëzgjatje të përcaktuar.

## OBJEKTI

### ARTIKulli 8

Objekti i veprimtarisë shoqërisë private " ÇEKANI " Shpk do të jetë:

1. Prodhimi, tregëtimi, shfrytëzimi i pyjeve, përpunimi i lëndës drusore dhe i qymyreve prej druri, i gëlqerës për eksportin e saj etj.

Hajdar Çekani

2. Mbarështrimi i pyjeve.
3. Përmirësimi i pyjeve.
4. Pyllëzime.
5. Sistemime malëre.
6. Mbarështrimi i florës barishtore, mjekësore, tanifere.
7. Mbarështrimi i faunës pyjore.
8. Mbrojtjen nga sëmundjet, dëmtuesit nga zjarri.
9. Mbarështrimi i kullotave dhe livadheve.
10. Ndërtimi e meremetimi i veprave ujore në kullota e livadhe.
11. Tregëtimi me shumicë i mallrave të ndryshme ushqimore, industriale, të ndërtimit etj.

### KAPITALI I SHOQËRISË

#### NPNI 10

Kapitali i shoqërisë private " CEKANI " Shpk, do të jetë në vlerën 100.000 ( Njëqindmijëlekë ) lekë. I gjithë ky kapital derdhet dhe është në disponim të administratorit të vetëm Z. Hajdar Cekani.

#### NPNI 11

Kapitali themelor mund të rritet me shtimin e aktivitetit të shoqërisë.

Në raste të ndryshme, lejohet që në këtë shoqëri të futen edhe administratore të tjerë duke zbatuar të gjitha dispozitet ligjore që rregullojnë këtë marrëdhënie juridike.

### DREJTIMI ADMINISTRATIV

#### NPNI 12

Shoqëria private " CEKANI " Shpk, me qendër në qytetin Librazhd do të ketë si administrator të vetëm themeluesin e shoqërisë Z. Hajdar Cekani.

#### NPNI 13

Administratori ka për detyrë organizimin dhe drejtimin e të gjithë veprimtarisë së shoqërisë. Ai kryen të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

Hajdar Cekani  
*[Signature]*

ARTI 14

Administratori i shoqërisë private " CEKANI " shpk i kryen vetë ose me akt përfaqësimi nga ana e tij të gjitha veprimet juridikë me persona fizikë, persona juridikë privatë, publik, apo të huaj.

MARËDHËNIET FINANCIARE

ARTI 15

Shoqëria private " CEKANI " shpk, për interes të shoqërisë, mund të lidhë kontrata në kushtet e ekonomisë së tregut me subjekte privatë, publik ose të huaj.

ARTI 16

Personi i vetëm që ka të drejtën e lidhjes së kontratave në emër të shoqërisë private " CEKANI " shpk është administratori i vetëm i saj. Por, në raste të veçanta, këtë detyrë mund ta kryejë çdo person tjetër i paisur me aktin e përfaqësimit nga administratori i shoqërisë.

ARTI 17

Shoqëria private " CEKANI " shpk përgjigjet për kontributin fiskal, sigurimet shoqërore, si dhe detyrimet e tjera të përcaktuara nga ligji. Ajo ka të drejtë të çelë llogari likuiduese pranë bankave të vendit, si dhe të kryejë veprimet përkatëse likuiduese.

ARTI 18

Për sigurimin e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë, ajo ka të drejtë të vetfinancohet me monedhë vendase ose të huaj.

ARTI 19

Në pasqyrimin e aktivitetit privat, administratori, ose personat e tjerë të caktuar prej tij, janë të detyruar të mbajnë dokumente të rregullta dhe rregjistrat përkatës sipas ligjit mbi kontabilitetin.

ARTI 20

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë mbaron në muajin dhjetor të çdo viti. Administratori, ose persona të caktuar prej tij, janë të detyruar të paraqesin bilancin vjetor dhe deklaratën e të ardhurave dhe

*Hasjan Celani*  
Flet

ta depozitohen atë në organin financiar të juridiksionit përkatës.

MARËDHËNIET E PUNËSIMIT

NEUNI 21

Administratori vendos vetë për caktimin, shtimin ~~ose~~ paktimin e të punësuarve në shoqëri.

NEUNI 22

Marëdhëniet juridike të punësimit brenda shoqërisë rregullohen sipas kontratës së punës në konformitet me dispozitat ligjore të fiksuar në legjislacionin shqiptar.

NEUNI 23

Marja në punë bëhet me rregjistrimin nga punëdhënësi në librin e shoqërisë, si dhe duke njoftuar organet e Punës së juridiksionit ku kryhet aktiviteti i shoqërisë.

NEUNI 24

Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punës bëhet në bazë të një akti të lëshuar nga administratori themelues.

Largimi nga puna lidhet me mbarimin e kontratës së punës, për shkak të shkeljeve të disiplinës së punës, si dhe në raste të tjera të përcaktuara nga ligji.

NEUNI 25

Pas shlyerjes së detyrimeve fiskale, detyrimeve të tjera ndaj shtetit, sigurimeve shoqërore etj, të ardhurat kalojnë në pronësi të themeluesit të vetëm, administratorit.

ZGJIDHJA E MOSMARRRËVESHJEVE

NEUNI 26

Mosmarreveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë private "CEKANI" shpk, do të zgjidhen me mirkuptim dhe, kur ky nu është i mundur, palët duhet t'i drejtohen gjykatës së rrethit Librazhd.

NEUNI 27

Për sa nuk është shprehur në këtë statut, gjithçka i referohet Ligjit Nr.7638 në veçanti dhe legjislacionit shqiptar në përgjithësi.


*Haydar Celani*

Statuti i Shoqërisë Tregëtare Private " ÇEKANI " shpk është hartuar me vullnetin e lirë të themeluesit të saj Z.Hajdar Cekani.

THEMELUESI I STATUTIT

ADMINISTRATORI

HAJDAR ÇEKANI



REPUBLIKA E SHQIPERISË

NOTERIA TIRANË

Nr. 503 / Rep.

Nr. 133 / Kol.

V E R T E T I M

Sot në datë 11/6 / 1997, në Zyrën e Noterisë Tiranë para meje noteres Almuza Sadushi, u paraqit personalisht qytetari Hajdar Cekani, i biri i Hamitit, i datlindjes 1959, banues ne qytetin e Librazhdit, me Nr. Leternjoftimi UG Nr. 090492, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga leternjoftimi i sjellë, i cili deklaron se ka hartuar vetë këtë statut dhe pasi është nënshkruar prej tij, vërtetohet nga unë Noterja.

NOTERE



MIMOZA SADUSHI  
NOTERE  
TEL - 349-59